



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KONISPOL

Konispol më 08.07.2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

I mbajtur sot më datë **08.07.2024** në Konispol , nga ana e Njesisë së Prokurimit me qëllim zbardhjen e procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të kërkesave të vecanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit ‘E Hapur e Thjeshtuar ‘ , dhe në referim të urdhërit të prokurimit nr.6 datë 01.07.2024 , me të dhënat si vijon:

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:

"Rehabilitim i kanalit vadtës të "Manastirit"

- Fondi limit **11 375 129** (Njëmbëdhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e njëzetë e nëtë) **Lekë , pa TVSH**
(Financimi në 2 vite, 5 538 530 për vitin 2024 dhe 5 836 599 për vitin 2025)
- Lloji procedurës së prokurimit: **E Hapur e thjeshtuar**
- Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **30 ditë**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia KONISPOL**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe si dhe në Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar.

2.2 Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Vërtetim për xhiron mesatare vjetore për vitet 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43, pika 2/b, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:* c) Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

- Kopje të vërtetuara të bilanceve të viteve ushtrimore 2022 dhe 2023 të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në

të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

- Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2023 nga njësitë e qeverisjes vendore ku ka pasur selinë e zhvillimit të aktivitetit dhe ne të gjitha niptet sekondare që operatori ka në QKB. (Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në :

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, ose
- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

a. Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin e vleresimit, shoqëruar me:
- Kontratë
- Situacionin përfundimtar;

- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim.
- Faturat tatimore

(Në rastet e bashkimit të operatoreve të paraqitet kontrata noteriale e bashkëpunimit)

b b. Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratë / vërtetime ku shënohet, vlera, koha dhe natyra e punës së bërë
- Faturat tatimore.
- Formular vlerësimi , shoqëruar me aktin e kolaudimit dhe situacionin perfundimtar.
- Leja e ndërtimit

(Në rastet e bashkimit të operatoreve të paraqitet kontrata noteriale e bashkëpunimit)

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, ofertuesi duhet të paraqesë krahas dokumentacionit të mësipërm, dhe kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë :

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4.. *ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”... i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat **30%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera

limit të kontratës që prokurohet , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,neni 39,pika 8 *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998“*Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit*” (i ndryshuar), ., Udhezimi i K.M nr.2 ,datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”,Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 ”Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit “ te ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për te vertetuar kerkesat e percaktuara në nenin 39 pika 5/a dhe b, duhet të paraqesin Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, kontratat e sipërmarrjes , situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit, Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim për punët e kryera me entet publike, që Autoriteti Kontraktor te bindet që operatori ekonomik me ane të dokumentacionit të paraqitur plotëson kriterin për punë të ngjashme ku shihen zerrat e punimeve që ka realizuar , koha e realizimit , dokumentacioni i kolaudimit dhe marrjes ne dorezim të objektit si dhe vleresimi i dhene nga Autoriteti Kontraktor,elemente të nevojshme për te gjykuar për plotësimin e kriterëve për punë të ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të deshmojnë se disponojnë license profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës.

Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008; *Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi*”, I ndryshuar.

Liçensa profesionale e shoqërise, e vlefshme, me kategoritë:

- NP – 1A Punime gërmimi në tokë
- NP- 4A Rruge ,autostrada,mbikalime..
- N.P - 5A Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
- N.P - 7A Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje.
- NS - 18A Punime topogjeodezike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi	Pikat 1 të të gjithë rubrikave të preventivit	Niveli A	
<u>Kategoria NP-4</u>	Rruge, autostrada, mbikalime..	Rubrika G	Niveli A	
<u>Kategoria N.P - 5</u>	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Rubrika A, C, D,E,F	Niveli A	
N.P - 7	Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje	Vepra është vepër vaditje	Niveli A	
<u>Kategoria NS-18</u>	Punime topogjeodezike	Është e nevojshme për piketimin e objektit sipas kuotave të projektit	Niveli A	

2.3.3 Ofertuesi duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve dhe e stafit të jetë jo më pak se 30 punonjës për periudhën Janar 2024 – Qershor 2024. Për përmbushjen e kësaj pike, në rast se shpallet fitues, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj në periudhën e lartpërmendur.
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të konfirmuar nga autoriteti përkatës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Bazuar në analizat e cmimeve për zërat e preventivit ku për çdo zë jepen orët e punës të nevojshme, makineritë që kërkohen në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës.

Ne lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kërkesë është e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.4 Operatori duhet të deshmojë se ka drejtues teknik që do të angazhohet për realizimin e punimeve stafin e mëposhtem ;

a.Stafi i drejtuesve teknik i shoqërisë të ketë në përbërje :

Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
--------------------	---------

Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
-----------------------	---------

Për stafin e mësipërm të paraqiten:

Kontratë punë të vlefshme.

Diploma.

Drejtuesi teknik i projektit të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 i ndryshuar

Është kërkuar inxhinier ndërtimi për zbatimin e punimeve në përputhje me zërat e punimeve të preventivit, projektit, specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive perkatese në licencën perkatese të zbatimit, Inxhinieri ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve.

Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve që vendosen në objekt .

Për sa i përket inxhinierit hidroteknik, është vendosur duke qënë se kemi të bëjë me një vepër vaditje dhe që mund të punohet dhe në prani uji.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit**, te pajisur me kontratë pune (të vlefshme), ose të kontraktuar në rastin kur makineritë janë me qira (për manovratorët), me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën:

Manovrator	1 (një)	punonjes
Shofer	1 (një)	punonjes
Saldator	1 (një)	punonjës

Manovratori duhet të jetë punonjës i specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda (Eskavatorist) dhe (Automakinist) dhe për këtë duhet të paraqesë dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.
Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlloruarit në si dhe mjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kontratës.

Kërkesa që punonjesit e me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë bazuar duke vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme sipas dispozitave të ligjit nr.8734, datë 1.2.2001 për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar

Kërkesa për dëshmitë e manovratorëve bazohet në Urdhërin e Ministrit të Infrastruktursë dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”

2.3.6 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 tonë	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri në 10 tonë	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Autobetonjere me kapacitet transportues 5-12 m3	në pronësi ose me qira	Cope 1
4	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Cope 1
5	Fabrikë për prodhimin e materialeve inerte, të pajisur me dokumentacionin ligjor përkatës, (Leje Mjedisore Kodi III.1B)	në pronësi / me qira / kontrate furnizimi	Cope 1
6	Fabrikë për prodhimin e betonit, të pajisur me dokumentacionin ligjor përkatës, (Leje Mjedisore Kodi III.1B, certifikate cilesie ISO 9001- 2015 (e vlefshme), e vendosur jo më larg se 50 km nga objekti (Manastir) në pikën me kordinata 509133.18, 4395126.29 sipas sistemit KRGJSH..	në pronësi / me qira / kontrate furnizimi	Cope 1

2.3.6.1 Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 25 (Njëzetë e pesë) copë
 - Jelekë minimumi 25 (Njëzetë e pesë) copë
 - Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 1 (Një) copë
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 3 (tre) copë
 - fikse zjarri te levizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 (dy) copë;
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit:
 - çertifikaten e pronësisë;
 - leja e qarkullimit;
 - siguracionin;
 - taksat vjetore
 - leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatëse;

ndersa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale qerash e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve si dhe fotografi

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndersa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerash e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në perfundimin e plotë të punimeve si dhe fotografi
- Për pajisjet duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, dhe fatura tatimore përkatëse, ndersa për pajisjet të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerash e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në perfundimin e plotë të punimeve.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Makinertë janë vendosur bazuar në zërat e preventivit dhe proceseve të punës për realizimin me sukses të veprës.

2.3.7 Për të përmbushur kërkesat e cilësisë në zbatim të legjislacionit në fuqi:

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Certifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të menaxhimit të cilësisë **ISO 9001 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën

- ISO nderkohe qe secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizoje sipas akt-marrëveshjes).
- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë mbi sistemet e menaxhimit të ambientit **ISO 14001 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe qe secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizoje sipas akt-marrëveshjes).
 - Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë **OHSAS 18001 / ISO 45001 (e vlefshme)** (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe qe secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizoje sipas akt-marrëveshjes).

Çertifikatat të jenë në gjuhën shqipe ose te përkthyer dhe të noterizuara.

Argumentimi: Në zbatim të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga projektuesi dhe janë pjesë e dosjes teknike

*Specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.